



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 30 SHTATOR 2015

BUXHETI I KOSOVËS

(GRANDI QEVERTAR, TË HYRAT E DEDIKUARA DHE DONATORËT)

Raportet sipas:

- a) Rregullorja Financiare nr. 06/2011 të Ministrisë së Financave; dhe
- b) Neni 20 të ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit:
 - Neni 20: Raportet, buxheti dhe llogaritë
 - Neni 20.1.1.1. pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë.

30 TETOR 2015



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**PASQYRAT FINANCIARE TË BUXHETIT TË KOSOVËS
(FONDIT TË PËRGJITHSHËM QEVERITAR, TË HYRAVE TË DEDIKUARA DHE DONATORËVE)**

PËR PERIUDHËN DERI MË 30 SHTATOR 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

Nr.	Përshkrimi	Faqe
1	Deklarata për Prezantimin e Pasqyrave Financiare	
2	Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme	1
3	Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale	2
4	Shënimet Shpjeguese të pasqyrave financiare	3-24

SHTOJCA E PASQYRAVE FINANCIARE– Buxheti i Kosovës (Tabelat faqe 1 – 32 në vazhdim , faqe 1 -8 plasni i zbatimit të rekomandimeve të ZAP dhe 1 –77 Raporti i aktiviteteve)		
Tabela 1.	Raporti i ekzekutimit të buxhetit (Grandi Qeveritar, Donatorëve dhe të Hyrave të Dedikuara)	1
Tabela 2.	Raporti i pranimeve sipas Programeve buxhetore	2
Tabela 3.	Rrjedha e parasë së gatshme	3
Tabela 4.	Përmbledhje e pagesave të realizuara ndaj ofruesit të shërbimeve profesionale	4
Tabela 5.	Gjendja e faturave të papaguara	5-6
Tabela 6.	Raporti për detyrimet kontigjente	7
Tabela 7.	Raporti i llogarive të arkëtueshme	8
Tabela 8.	Raporti i avanseve të pambyllura dhe huave	9

Tabela 9.	Raporti i pasurive jo – financiare	10-13
Tabela 10.	Raporti i zhvlerësimi të pasurive	14
Tabela 11.	Raporti mbi ndryshimet në ndarjet buxhetore nga të hyrat e dedikuara	15-16
Tabela 12.	Raporti mbi ndryshimet në ndarjet buxhetore nga grandit qeveritar	17-18
Tabela 13.	Raporti i numrit të punëtorëve	19
Tabela 14.	Pasqyra kryesore – të hyrat e dedikuara	20
Tabela 15.	Pasqyra sipas nënvijave buxhetore – të hyrat e dedikuara	21-22
Tabela 16.	Raporti i transfereve në mes të programeve buxhetore	23
Tabela 17.	Raporti i administratës qendrore – të hyrat e dedikuara	24
Tabela 18.	Raporti i auditimit – të hyrat e dedikuara	25
Tabela 19.	Raporti i Departamentit Ligjor – të hyrat e dedikuara	26
Tabela 20.	Raporti i Njësisë së Riorganizimit dhe Administrimit të Ndërmarrjeve Shoqërore – të hyrat e dedikuara	27
Tabela 21.	Raporti i Departamentit për Koordinim të Likuidimit – të hyrat e dedikuara	28
Tabela 22.	Raporti i Departamentit të Shitjes – të hyrat e dedikuara	29
Tabela 23.	Raporti i Shpenzimeve sipas kodeve ekonomike – të hyrat e dedikuara	30
Tabela 24.	Pasqyra Kryesore – Grandi Qeveritar	31
Tabela 25.	Raporti i njësisë së riorganizimit dhe Administrimit të NSh-ve (Trepça) – Grandi Qeveritar	32
Tabela 26.	Plani i Zbatimit të Rekomandimeve të Zap-së të dhëna në raportin e auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2014 për fondin e privatizimit dhe agjencinë kosovare të privatizimit	1 - 8
Raporti i aktiviteteve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën Janar – Shtator 2015.		1-77



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Fatmir PLAKIQI

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit, Ministria e Financave

DEKLARATË PËR PREZENTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

I nderuari z. Plakiqi,

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë edhe shënimet shpjeguese për këto pasqyra, për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2015 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme" dhe i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMPFP) nr.03/L-48, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe ligjin nr. 04/L-194 dhe janë bazuar në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezentimin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës për organizatën buxhetore **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)** për vitin që përfundon më 30 Shtator 2015.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqjen apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare;
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhur me Buxhetin e Kosovës, (fondi i përgjithshëm Qeveritar, të hyrat e dedikuara dhe donatorët) janë të plota dhe të sakta;
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta;
- Nuk ka llogari bankare që ndërlidhen me Buxhetin e Republikës së Kosovës, përveç llogarive bankare të fondeve në mirëbesim të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si më datën 30 Shtator 2015;
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare në rast se do të shkeleshin;
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare;
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur; dhe
- Të gjitha huatë për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës raportuese i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara që janë të bashkangjitura paraqesin një prezentim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe të transaksioneve financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2015.

Avni J. Jashari

Avni J. JASHARI, MSc, CA, CFE, IS

u.d. Zëvendës Drejtor Menaxhues - likuidimit
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Adem Selishta

Adem SELISHTA

u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit
Agjencia Kosovare e Privatizimit

**PASQYRAT FINANCIARE DHE SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PERIUDHËN
JANAR – SHTATOR 2015**


(faqe 1 deri 24)

Pasqyra financiare 1
PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE NË PARA TË GATSHME
për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2015

Kodi i AKP-së në Ministrinë e Financave:

239

Shënimi	Janar - Shtator 2015				Janar - Shtator 2014				Janar - Shtator 2013			
	Llogaritja e Vetme e		Fondet në		Llogaritja e Vetme e		Fondet në		Llogaritja e Vetme e		Fondet në	
	Thesari	Buxheti i Kosovës	Mirëbesim të AKP-së	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Thesari	Buxheti i Kosovës	Mirëbesim të AKP-së	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Thesari	Buxheti i Kosovës	Mirëbesim të AKP-së	Pagesat nga palët e treta të jashtme
BURIMET E FONDEVE												
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm	2	7,573.39	-	-	19,861.00	-	-	-	-	-	-	-
Të Hyrat vetanake	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
nga Fondi me qëllime të dedikuara		4,306,878.88	-	-	4,317,352.50	-	-	-	3,775,483.19	-	-	-
ranlet e Përcaktuara të Donatorëve	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fondi i Huazimeve	5	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	6	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pranimet tjera	7	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fondet në Mirëbesim të AKP-së	7a	-	580,829.424	-	-	-	655,621,846	-	-	-	618,822,344	-
Gjithsej		€ 4,314,452.27	580,829.424	€	€ 4,337,213.50	655,621,846	€	€	€ 3,775,483.19	618,822,344	€	€
SHFRYTËZIMI I FONDEVE												
Operacionet												
Pagat dhe Medijet	8	3,227,702.74	-	-	2,864,449.10	-	-	-	2,222,912.53	-	-	-
Mallrat dhe Shërbimet	9	924,029.06	-	-	1,281,964.01	-	-	-	1,415,419.77	-	-	-
Shërbimet Publike	10	64,797.33	-	-	57,260.97	-	-	-	67,537.92	-	-	-
		€ 4,216,529.13	-	€	€ 4,203,674.08	-	€	€	€ 3,705,870.22	-	€	€
Transferet												
Transferet dhe Subvencionet	11	87,433.14	-	-	40,633.42	-	-	-	56,862.97	-	-	-
Shpenzimet Kapitale												
Prona, Ndertesa dhe Pajisjet	12	10,480.00	-	-	92,900.00	-	-	-	12,750.00	-	-	-
Pagesat/Daljet tjera	13	-	31,620.609	-	-	-	89,849,103	-	-	-	50,345,767	-
Kthimi i huazimeve	14	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		€ 4,314,452.27	31,620.609	€	€ 4,337,213.50	89,849,103	€	€	€ 3,775,483.19	50,345,767	€	€
Shumat e paraqitura në pagesa, paraqesin ato të bera nga buxheti i Kosovës, të hyrat e dedikuara, grantet dhe fondet në mirëbesim.												
Gjendja e pranimave të pashipenzuara		€	-	549,208,815	€	-	565,772,743	€	€	-	568,476,557	€


Përgatitur nga: A.S. dhe K.L.

Pasqyra financiare 2

Pasqyra e kratesimit të shumave buxhetore dhe aktuale
Për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2015

	Janar - Shtator 2015				Janar - Shtator 2014		Janar - Shtator 2013	
	Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti Final (Ndarja) B	Realizimi C	Ndryshimi D=C/B %	Realizimi E	Realizimi F	Realizimi	Realizimi
	€	€	€	%	€	€	€	€
Shënime								
Hyrja e parase se gatshme në llogari të thesarit								
15 Tatimet	-	-	-	-	-	-	-	-
16 Të hyrat e dedikuara	6,811,383.00	6,811,383.00	6,811,383.00	100%	7,345,873.00	8,048,000.00	8,048,000.00	8,048,000.00
17 Grantet dhe ndihma	-	-	-	-	-	-	-	-
18 Pranimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-	-
19 Fondi i privatizimit*	-	-	-	-	-	-	-	-
20 Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-	-	-
21 Huazimet	-	-	-	-	-	-	-	-
22 Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Pranimet totale të mbledhura për BKK-në	€ 6,811,383.00	€ 6,811,383.00	€ 6,811,383.00	100.00%	€ 7,345,873.00	€ 8,048,000.00	€ 8,048,000.00	€ 8,048,000.00
Daljet e parase se gatshme nga llogaritë e thesarit								
23 Pagat dhe medijet	3,886,391.00	3,886,391.00	3,227,702.74	83.05%	2,864,449.10	2,222,912.53	2,222,912.53	2,222,912.53
24 Mallrat dhe Shërbimet	6,066,992.00	4,477,171.00	924,029.06	20.64%	1,281,964.01	1,416,419.77	1,416,419.77	1,416,419.77
25 Shërbimet publike	98,000.00	98,000.00	64,797.33	66.12%	57,260.97	67,537.92	67,537.92	67,537.92
26 Transferet dhe Subvencionet	80,000.00	116,334.00	87,433.14	75.16%	40,639.42	56,862.97	56,862.97	56,862.97
27 Shpenzimet kapitale	80,000.00	80,000.00	10,490.00	13.11%	92,900.00	12,750.00	12,750.00	12,750.00
28 Fondi i privatizimit*	-	-	-	-	-	-	-	-
29 Kthimi i huazimeve	-	-	-	-	-	-	-	-
30 Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali nga BKK nëpërmes të LIVTh	€ 10,211,383.00	€ 8,657,896.00	€ 4,314,452.27	49.83%	€ 4,337,213.50	€ 3,775,483.19	€ 3,775,483.19	€ 3,775,483.19


Shumat e paraqitura në pagesa (daljet) në kolonën A dhe B, paraqesin buxhetin e hyrave të dedikuara dhe Grandin Qeveritar

Shumat e paraqitura në pagesa (daljet) në kolonën C, paraqesin pagat e hyrave të dedikuara dhe Grandit Qeveritar

Përqindja e shpenzimeve prej 50% përfshinë edhe buxhetin e Grandit qeveritar.

* Sipas konsultimeve me Departamentin e Thesarit, kjo ka të bëjë me fondin e privatizimeve të kryera nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Fondet në Mirëbesim të AKP-së janë paraqitur në Pasqyrën e Pranimëve dhe Pagesave dhe shpëlbosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.


Përgatitur nga: A.S. dhe K.L.

SHËNIMET SHPJEGUESE

SHËNIMET SHPJEGJUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2015

Shënimi 1: Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj) dhe politikat kontabël)**1.1. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare:**

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Këto pasqyra financiare i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga udhëzimet administrative të Ministrisë së Financave dhe janë të bazuar në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare formojnë pjesën përbërëse të pasqyrave financiare dhe duhet të lexohen së bashku dhe në ndërlidhje me pasqyrat financiare.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë tërë periudhës raportuese.

Korrigjimet në kontabilitet:

Gjatë periudhës raportuese është kërkuar që Departamenti i Thesarit të bëjë korrigjimin në kontabël të debitit së mbivlerësuar prej ¹EUR 377.00. Kjo vlerë nuk reflekton në pagesat e bëra gjatë kësaj periudhe raportuese. Kjo vlerë e nënvlerëson trajtimin kontabël të të hyrave (kreditit).

1.2. Subjekti Raportues:

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar sipas Ligjit nr. 03/L-067 (në fuqi më 1 Korrik 2008), i ndryshuar me ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si organi i pavarur publik me zotësi të plotë juridike është pasardhëse (sa i përket Ndërmarrjeve Shoqërore) e ish- Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/18.

Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej 1 Janar deri më 30 Shtator 2015.

Raportet e pasqyrave financiare janë paraqitur në Tabelën e Përmbajtjes.

Pasqyrat Financiare janë për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit kontrollohet nga Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore.

¹ Shih dokumentin "Procesi i Barazimit të Shënimeve në SIMFK dhe Regjistrave Kontabël të AKP-së për periudhën Janar – Shtator 2015"

Në paltim me ligjin nr. 03/L-067 (ligjin mbi themelimin e AKP-së) dhe me ligjin e ndryshuar nr. 04/L-034 më 21 Shtator 2011, aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) nëpërmjet të metodave të "spin off-it" dhe shitjeve të asetëve përmes likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore. Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, rristurimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja dhe likuidimi i plotë i Ndërmarrjes. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerave të NSh-ve në Kosovë. Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk kontrollon subjekte tjera të cilat janë apo mund të jenë konsoliduar në aktivitetet e tyre në këto pasqyra financiare.

Aktivitetet e AKP-së gjatë periudhës raportuese janë financuar nga Të Hyrat e Dedikuara dhe Granti Qeveritar.

Sipas Ligjit të LMFP-së (neni 64) dhe Ligjit të AKP-së 04/L-034 (neni 21), Të Hyrat e Dedikuara janë 5% i të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, është tarifë administrative për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative.

Granti Qeveritar është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, ky burim ka financuar aktivitetet që kanë të bëjnë me riorganizimin e NSh-ve (Trepça) e cila është nën kompetencën e Agjencisë sipas Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore.

1.3. Pagesat nga palët e treta:

Pagesat e bëra nga pala e tretë nuk përbëjnë pranimet e parave apo pagesave nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por janë për përfitimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Këto pagesa janë të paraqitura në kolonën "Pagesat nga Pala e Tretë" në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave.

Gjatë periudhës raportuese Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar nga shërbimet e bëra në interes të saj si rezultat i pagesave me para të bëra nga palët e treta jashtë Qeverisë apo Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

1.4. Llogaria e vetme e Thesarit (LLVTH):

Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk operon me llogaritë e veta bankare sa i përket ndarjeve buxhetore që pranon nga Grandi Qeveritar. Qeveria operon me funksionin qendror të thesarit që administron shpenzimet e parave që indodhin dhe pranimet e parave të mbledhura nga të gjitha organizatat buxhetore gjatë vitit financiar.

Që nga Janari 2012 shpenzimet operative dhe administrative mbulohen nga Të Hyrat e Dedikuara të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Sipas Ligjit të AKP-së, Agjencia shfrytëzon ²5% e të gjitha shitjeve dhe realizimeve të tjera për mbullimin e shpenzimeve operative dhe administrative. Thesari ka hapur llogari të veçantë në fondin e Buxhetit të Kosovës me emër të llogarisë AKP Privatizimi Tarifa Administrative dhe numër të llogarisë 1000400070004642. AKP transferon periodikisht të hyrat e dedikuara në këtë llogari bankare, në mënyrë që të financohen aktivitetet e vitit përkatës fiskal.

² Shih nenin 21 të Ligjit 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe faqe nr. 44/45 Tabela 22 – Llogaria e Tarifës Administrative të fondeve në mirëbesim.

Sa i përket fondeve në mirëbesim, bazuar në ligjin mbi themelimin e AKP-së dhe procedurave bankare të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, AKP operon me llogaritë bankare në mirëbesim të mbajtura në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Shënime shtesë për këto llogari janë shpalosur në shënimin 6a.

1.5. Kthimet e Shpenzimeve nga viti paraprak:

Sipas Ligjit MFPP, paratë e kthyer në Fondin e Konsoliduar të Kosovës nga viti paraprak regjistrohen si ³pranime (të hyra) në vitin aktual. Ndërsa, paratë e kthyer në Fondin e Konsoliduar të Kosovës nga viti aktual (vijues) regjistrohen si zbritje e shpenzimeve të vitit aktual.

1.6. Valuta raportuese:

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në tabelat përkatëse.

1.7. Data e autorizimit të pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare janë autorizuar për lëshim më 30 Tetor 2015 nga: Avni J. Jashari u.d. Zëvendës Drejtor Menaxhues - Likuidimi në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Adem Selishta u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit.

1.8. Softveri që përdoret për Pasqyrat Financiare dhe Raportet Financiare të AKP-së:

Drejtori i Departamentit të Financave dhe Buxhetit ka dizajnuar programin në Microsoft Excel për të përgatitur Pasqyrat Financiare të AKP-së dhe Raportet Financiare të AKP-së.

Personeli i AKP-së që punon në këtë softuer është Adem Selishta u.d. Drejtor i Departamentit të Financave dhe Buxhetit dhe Korab Lufi u.d. Kryesues i Njësisë së Fondeve në Mirëbesim. Të dy këta dizajnojnë, freskojnë dhe bëjnë zgjidhjen e problemeve e softuerit. Gjithashtu janë mbikëqyrës, bëjnë harmonizimin bankar dhe janë përgjegjës për kontabilitetin, raportimin financiar si dhe persona ndërlidhës me Thesarin për harmonizimin e shpenzimeve. Hyllja Shileku, Zyrtare e Pasurisë dhe Buxhetit, bënë azhurnimin ditor të raportit (shpenzimeve dhe zotimeve) dhe ruan kopjet rezerve të softuerit.

Ruajtja e kopjeve e të dhënave në softuer: Ruajtja e raportit financiar bëhet me referencë të datës (p.sh. referenca "150930-raporti i llogarive në BQK" duhet të lexohet siç vijon: Raporti i llogarive në BQK për datën 30 Shtator 2015). Ruajtjet tjera bëhen në diskun kryesor në dy kompjuterë të ndryshëm, në serverin e teknologjisë Informative të AKP-së në rrjetin e foliderit të përbashkët të Raporteve Financiare. Njësia e Teknologjisë Informative bën në mënyrë automatike (ang. "shadow copy") kopje të përditshme e të dhënave në server në formë elektronike si dhe kopje javore në formatin e shiritave magnetik. Kopjet në CD (Compact Disc) bëhen pas dorëzimit të Pasqyrave Financiare në MF-ve.

Kopjet shpërndahen siç vijon: Ministrinë e Financave Departamentin e Thesarit, Drejtorin Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues, dy për Departamentin e Financave dhe Buxhetit, Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Njësinë e Arkivës së AKP-së.

³ Shih faqe nr.2 Tabela 2 – Raporti i Pranimeve sipas programeve buxhetore.

1.9. Tabelat e kontrollimit automatik të gabimeve:

Janë të dizajnuara 22 tabela të cilat automatikisht kontrollojnë se a gjenerohen rezultate të njëjta që marrin pika referuese të ndryshme. Në rast se të dhënat regjistrohen gabimisht në softuer, këto tabela automatikisht gjenerojnë ndryshimin në rezultate dhe formatizohen me ngjyrë të kuqe të qelizës dhe me formatizim të nxirë ("bold").

1.10. Personeli i Autorizuar ne Zotime dhe Urdher Pagesa (UOB):

Zyrtaret Administrativ: Edita Zeka, Nora Ibishaga Budima, Hylja Shileku, Shaban Vitija.
 Mbajtësit e Buxhetit (Zyrtarët Autorizues): Drejtorët e Departamenteve dhe zyrtarët tjerë sipas vendimit me shkrim të Drejtorit Menaxhues, përkatësisht për programe të ndryshme buxhetore.
 Zyrtar Certifikues: Sahare Miftari; Zyrtar Certifikues Alternativ: Valon Fetahu
 Zyrtar i Shpenzimeve: Eljesa Osmani; Zyrtar Alternativ Shpenzues: Shaban Vitija
 Zyrtar Zotues: Rrezearta Jajaga, Zyrtar Alternativ Melita Cana
 Drejtori i Prokurimit: Marjan Perlaska, Zyrtar Alternativ Merita Zeka

1.11. Përgatitja e pagesave:

Programi Buxhetor	Zyrtari përgjegjës:
Administrata Qendrore: nënvijat buxhetore të mallrave dhe shërbimeve dhe shërbimeve publike	Edita Zeka
Administrata Qendrore: avanset e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	Nora Budima
Administrata Qendrore: projektet kapitale	Hylja Shileku
Njësia e Auditimit	Shaban Vitija
Departamenti Ligjor	Shaban Vitija
Njësia e Riorganizimi dhe administrimi i NSh-ve	Hylja Shileku
Departamenti për Koordinim të Likuidimit	Nora Budima
Departamenti i Privatizimit	Edita Zeka

1.13. Llogaritë Bankare:

Drejtori Menaxhues i AKP-së apo sipas LMFP-së Zyrtari Kryesor Administrativ: Përfaqësues Ligjor i të gjitha llogarive bankare në mirëbesim. Të drejtat e nënshkrimit në llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim janë të përcaktuara me procedurat bankare të AKP-së të aprovuara më datën 1 Shtator 2008, e ndryshuar më 28 Shtator 2011 pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të AKP-së. Procedurat bankare janë ndryshuar sërish më datën 27 Shkurt 2014.

Sipas nenit 11 dhe 15 të Ligjit të Agjencinë, Bordi i Drejtorëve e emëron Drejtorin Menaxhues të Agjencisë dhe dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues dhe për një vendim të tillë nevojiten së paku 5 vota afirmative. Nga data 26 Janar 2014, Agjencia nuk ka Drejtor Menaxhues dhe detyrat e tij sipas Aktit të Themelimit të Agjencisë i kanë kryer dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues bashkërisht. Për shkak të disa rrethanave të krijuara në fund të muajit Prill 2014, Bordi i Drejtorëve më 7

Përgatitur nga: A.S. dhe K.L.

Maj 2014 kishte marr vendimin që të pezulloj nga puna njërin nga zëvendës drejtorët Menaxhues të Agjencisë dhe të emëroj një ushtrues detyre në vendin e tij (ushtrues detyre i Zëvendës drejtorit Menaxhues - likuidimi). Në mbledhjen e mbajtur më 26 dhe 31 Gusht 2014, Bordi i Drejtorëve ka vendosur që të vazhdoj mandatin e ushtruesit të detyrës së Zëvendës drejtorit Menaxhues deri në vendimin e ardhshëm të Bordit të Drejtorëve.

Pas periudhës Gusht 2014 Bordi i Drejtorëve është shpërndarë. Kjo për shkak të mungesës së kuorumit, mungesë kjo, si rezultat i skadimit të mandatit të anëtarëve ndërkombëtar të Bordit.

Më datën 17 Shtator 2014, Zëvendës drejtoresha Menaxhuese e Agjencisë për Divizionin e Shitjes ka dhënë dorëheqje të menjëhershme dhe të parevokueshme.

AKP me datën 3 Tetor 2014 ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës kërkesën që të interpretoj dhe udhëzoj Agjencinë si në vijim:


- A mundet që një Zëvendës drejtor Menaxhues (aktualisht si zyrtari më i lartë administrativ në Agjenci dhe si Menaxhment në kuptim të nenit 3.1.15 të Ligjit për Agjencinë) të ushtroj detyrën si Zyrtar Kryesor Administrativ i Agjencisë.
- A mund të konsiderohet se në kuadër të termat *'instrumenteve tjera'* i cili përmendet në Aktin e Themelimit të Agjencisë (neni 6), përfshihen edhe *'transferet apo transaksionet bankare'* të fondeve në mirëbesim të Agjencisë.
- Në ndërlidhje me Aktin Themelues të Agjencisë (neni 6) dhe Procedurat Bankare të Agjencisë (neni 7), a konsiderohet se transferet bankare të fondeve në mirëbesim nga shuma 0 (zero) deri në shumën EUR 500,000 (pesëqind mijë euro) mund të nënshkruhen kolektivisht nga: Zëvendës Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, një Zëvendës Drejtor Menaxhues dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit.

Më 28 Tetor 2014 Dhomë e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar aktvendimin ku theksohet se Gjykata i kupton shqetësimet e Agjencisë dhe është e vetëdijshme për ndikimet që po shkaktohen në punën e saj si pasojë e mos funksionimit të Bordit. Megjithatë "gjykata nuk mund të ofroj zgjidhje (nëpërmjet interpretimit të dispozitave ligjore apo akteve tjera nënligjore të nxjerr nga Agjencia përfaqëse dhënie e çfarëdo përgjigje në pyetje të parashtruara) e cila do t'i mundësoj Agjencisë tejkallimin e pengesave që po ndikojnë në punën e saj në mungesë të Bordit të kompletuar dhe menaxhmentit pothuajse plotësisht jofunksional."

AKP-ja i është drejtuar Ministrisë së Administratës Publike me shkrësë më 25 Shtator 2014, lidhur me kërkesën për opinion ligjor, se a mundet vetëm një zëvendës drejtor në Agjenci të nënshkruaj si Zyrtar Kryesor Administrativ.

Më 15 Tetor 2014 Ministria e Administratës Publike ka lëshuar opinionin ligjor sipas të cilit: "në kuptim të dispozitave ligjore Drejtori Menaxhues i AKP-së duhet të zëvendësohet nga Zëvendës Drejtori Menaxhues i AKP-së e që në hierarkinë e organit të juaj është pozita më e lartë dhe vien menjëherë pas pozitës së drejtorit".

Synimet dhe qëllimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përcaktuar në nenin 2 (Synimi dhe Qëllimi) të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.


Përgatitur nga: A.S. dhe K.L.

Neni 2 (2.2.3) i Ligjit nr. 04/L-034 për AKP thekson: "brenda kufizimeve të burimeve të veta administrative, ushtron aktivitetet të arsyeshme ndihmëse për ruajtjen ose rritjen e vlerës, aktivitetit fitimprurës dhe qeverisjes së ndërmarrjeve dhe aseteve, deri në masën sa këto aktivitetet nuk e pengojnë ushtrimin e detyrave të përcaktuara"

Neni 2 (3) i Ligjit nr. 04/L-034 për AKP thekson: "Ky ligj do të zbatohet në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollin e saj."

Të tre anëtarët vendor të Bordit të Drejtorëve, u.d. Zëvendës Drejtori Menaxhues, Drejtori i Financave dhe Buxhetit, Drejtori Ligjor, Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve dhe Drejtori i Auditimit të Brendshëm kanë shqyrtuar situatën aktuale lidhur me detyrimin ligjor për ekzekutimin e transfereve bankare nga llogaritet në mirëbesim në mënyrë që të përmbushet mandati ligjor i Agjencisë.


Të gjitha këto detyrime janë detyrime ligjore që bazohen në Buxhetin Vjetor të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës (për pagat, mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale) apo që bazohen në vendimet e Bordit të Drejtorëve për transferimin e 20% për punëtorët e NSH-ve, buxhetet e aprovuara të likuidimit, kthimit të çmimit të shitjes apo depozitave të ofertesve jo të suksesshëm gjatë procesit të privatizimit, pagesat e punëtorëve të NSH-ve në likuidim, Ofruesit Profesional të Shërbimeve për likuidim dhe shërbimeve të sigurimit të aseteve të NSH-ve.

Pas shqyrtimeve të hollësishme të procedurave bankare të Agjencisë dhe detyrimeve ligjore në mirëbesim të Agjencisë, Agjencia ka ardhur në përfundim se për të përmbushur mandatin ligjor dhe detyrimet në mirëbesim të AKP-së, të gjitha transferet bankare të Agjencisë nga fondet në mirëbesim në Bankën Qendrore të Kosovës duhen të ekzekutohen nga u.d. Zëvendës Drejtori Menaxhues. – likuidimi (si zyrtar që e zëvendëson Drejtorin Menaxhues sipas opinionit ligjor të Ministrisë së Administratës Publike), Drejtori i Financave dhe Buxhetit dhe Zyrtari Certifikues i Agjencisë. Me këto nënshkrime sigurohet edhe parimi i nënshkrimit kolektiv që përcaktohet poashtu në procedurat bankare.

Në rast se nuk do të ekzekutoheshin këto transfere, atëherë Agjencia prezikonte të dështonte në detyrimin e vet ligjor të mirëbesimit ndaj Ndërmarrjeve Shoqërore dhe në shkellen e parimeve të përcaktuara në nenin 2.3 të Ligjit të AKP-së dhe të siguroj që zbatimi i Ligjit të AKP-së të jetë në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollin e saj.

Zyrtari Certifikues i Agjencisë nënshkruan çdo transaksion pas verifikimit dhe pasi që të jetë siguruar se transaksioni në fjalë përmban të gjitha elementet e duhura në përputhje me ligjin, politikat dhe procedurat e Agjencisë. Gjatë periudhës raportuese znj. Sahare Miftari: Certifikimi i transfereve bankare; Zyrtar Alternativ Certifikues është Valon Fetahu.

Përgatitur nga: A.S. dhe K.L.



Shënimi 2: Burimi i Fondeve**Ndarjet buxhetore të Grandit Qeveritar**

⁴Ndarjet buxhetore të Grandit Qeveritar përfaqësojnë vlerën e tërësishme të shpenzimeve të cilat janë financuar nga grandit i përgjithshëm dhe jo nga donatorët e përcaktuar apo çfarëdo fondi tjetër.

Ndarjet buxhetore të AKP-së menaxhohen nëpërmjet llogarisë së vetme të administruar nga thesari. Këto shuma nuk kontrollohen nga AKP-ja, por shpërndahen në emër të AKP-së nga administruesi i llogarisë së vetme pas kompletimit të dokumentacionit të duhur dhe autorizimeve ndërmjet KFMIS.

Vlera e raportuar si ndarje buxhetore në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave është vlera që thesari ka lëshuar nëpërmjet llogarisë së Vetme të Thesarit në emër të AKP-së (vlera e paraqitur më poshtë).

Vlera nuk reflekton pranimet aktuale të parave nga thesari, sepse AKP nuk kontrollon llogaritë e veta bankare (në thesar). Vlera reflekton burimin e fondeve që përdoren për pagesa.

Më poshtë është përmbledhja e natyrës së ndarjeve buxhetore nëpërmjet Grandit Qeveritar:

Klasifikimi Ekonomik	Janar - Shtator 2015		Janar - Shtator 2014		Janar - Shtator 2013	
	GQ	GQ	GQ	GQ	GQ	GQ
Paga dhe rroga	-	-	-	-	-	-
Mallra dhe shërbime	1,846,513		3,400,000		-	-
Shërbime komunale	-	-	-	-	-	-
Subvencionet dhe Transferet	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	€ 1,846,513	€ 3,400,000.00	€	€	€	€

⁴Shtih:

- Faqe nr. 1 Tabela 1 – Raporti i ekzekutimit të Buxhetit (Grandi Qeveritar, Donatorët dhe të Hyrat e Dedicuara)
- faqe nr. 17 Tabela 12 – Raporti mbi ndryshimet në ndarjet buxhetore nga Grandi Qeveritar;
- faqe nr. 65 të Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e vitit 2015 Tabela 3.1.A: Buxheti i Rishikuar për Nivelin Qendror;
- faqe nr. 46 të shtojcës të Ligjit nr. 05/L-046 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës - Tabela 3.1.A: Buxheti i Rishikuar për Nivelin Qendror.

Përgatitur nga: A.S. dhe K.L.

Vlera prej EUR 1,846,513.00 paraqet vlerën e buxhetit fillestar prej EUR 3,400,000.00 MINUS shkurtesën buxhetore gjatë procesit të rishikimit gjysmë vjetor (LIGJI Nr. 05/L-046), shkurtesa prej EUR 1,553,487.00.

2.1. Procesi i Rishikimit Gjysmë Vjetor për ndarjet buxhetore nga Grandi Qeveritar (LIGJI Nr. 05/L-046)

Duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Financave lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2015, AKP ka analizuar performancën e buxhetit kundrejt shpenzimeve të realizuara.

Si rrjedhojë, janë identifikuar nevojat për buxhet shtesë si dhe kursimet nga buxheti fillestar, të dyja këto të cilat, më datën 3 Qershor 2015 janë paraqitur në Ministrinë e Financave në planin për gjysmë vjetorin e dytë të buxhetit 2015.

Agjencia ka paraqitur kërkesën për mjete shtesë nga buxheti i Kosovës për programin e Likuidimit, gjegjësisht Autoritetin e Likuidimit në shumë prej EUR 5,300,000.00.

Kjo kërkesë, ashtu si kërkesa e vitit paraprak, është rezultat i opinionit të Auditorit ku në mes të tjerash thuhet se Ofruesi i Shërbimeve Profesionale duhet financuar nga Buxheti i Kosovës apo Donatorët. Agjencia ka paraqitur argumentet e saj se pagesat e ofruesve të shërbimeve mund dhe duhet financuar nga illogaritë e fondeve në mirëbesim.

Sidoqoftë, kërkesa prej EUR 5,300,000.00 ashtu si kërkesa e vitit të kaluar prej EUR 5,000,000.00 nuk është aprovuar.

Përveç refuzimit të financimit nga Buxheti i Kosovës të pagesave për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (kërkesës së Auditorit), Qeveria e Kosovës gjatë procesit të rishikimit të buxhetit ka reduktuar edhe buxhetin të nënvijës për planin e riorganizimit të Trepçës në shumë prej EUR 1,553,487.00.

Shënimi 3: Të Hyrat e Dedikuara

Ndarjet buxhetore për Të Hyrat e Dedikuara

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të AKP-së në Shtator të vitit 2011, AKP ka filluar të mbulojë shpenzimet e saj administrative dhe operative nga ⁵Të Hyrat e Dedikuara, duke filluar me pagat që nga Shtatori 2011, ndërsa që nga Janari i vitit 2012 duke u bazuar në ligjin e rishikuar të buxhetit, të gjitha shpenzimet operative të AKP-së financohen vetëm nga të hyrat e dedikuara.

⁵ Shih shënimet shpjeguese nr. 13.3 të pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim.

⁶ Shih nenin 21.2 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 64 të Ligjit nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Agjencia dhe Thesari, të dyja, veç e veç kanë hapur llogarinë bankare për trajtimin e të hyrave të dedikuara për Agjencinë. Thesari ka hapur llogarinë në fondin e Buxhetit të Kosovës me emër të llogarisë AKP Privatizimi Tarifa Administrative dhe numër të llogarisë 1000400070004642. Ndërsa Agjencia alokon mjetet e nevojshme në llogarinë e sipër shënuar të Thesarit (për financimin e buxhetit) nga llogaria AKP TARIFA ADMINISTRATIVE me numër të llogarisë 1000501000045681.

Të hyrat e dedikuara të cilat mbesin ⁸tepricë pas përfundimit të vitit, barten për buxhetin e vitit pasues.

Nga Agjencia janë transferuar gjithsej EUR 25,848,000.00 (Njëzet e Pesë milion e Tetë qind e katër dhjetë e tetë mijë) në llogarinë e tarifës administrative, e cila administrohet nga Thesari (shih më lartë). Shumat e transferuara sipas periudhave janë si më poshtë:

1. ⁹Gjatë vitit 2011 ka transferuar shumën prej 1.8 milion EUR për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative.
2. Për vitin fiskal 2012 shumën prej EUR 8,200,000.00 (tetë milion e dyqind mijë euro) të transferuara me datën 28 Maj 2012 për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative;
3. për vitin fiskal 2013 shumën prej EUR 8,048,000.00 (tetë milion e katër dhjetë e tetë mijë euro) të transferuara me datën 28 Dhjetor 2012 për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative;
4. për vitin fiskal 2014 shumën prej EUR 2,300,000.00 (dy milion e treqind e mijë euro) të transferuara më datën 18 Nëntor 2014 për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2014; dhe
5. për vitin fiskal 2015 shumën prej EUR 5,500,000.00 (dy milion e treqind e mijë euro) të transferuara më datën 15 Janar 2015 për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2015;

¹⁰Gjendja bankare e mjeteve më 30 Shtator 2015 dhe parashikimi i mjeteve për pagesat të Buxhetit deri më 31 Dhjetor 2015.

Tepricat nga viti i kaluar - Gjendja bankare më 1 Janar 2015	1,315,428.29	1
Transferimi i mjeteve gjatë 2015 prej EUR 5,500,000.00 dhe të hyrat nga kthimet e mjeteve prej EUR 4,799.50	5,504,799.50	2
Gjithsej të hyrat në llogari deri më 30 Shtator 2015	6,815,428.29	3=1+2
Pagesat e realizuara deri më 30 Shtator 2015 dhe tërheqja nga llogaria për parane e imët prej EUR 4,263.50	4,311,142.38	4
Gjendja bankare më 30 Shtator 2015	2,504,285.91	5=3-4

⁷ Shih nenin 64.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.

⁸ Shih nenin 21.3 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe nenin 6.7 të Ligjit nr. 05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

⁹ Më datën 3 Tetor 2011 në llogarinë nr. 1000400070004642 e cila menaxhohet nga thesari është ekzekutuar transaksioni prej EUR 1,800,000.00 nga llogaria nr. 1000500412001805 PAK Reserve Fund të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Të gjitha transaksionet tjera janë realizuar nga llogaria AKP TARIFA ADMINISTRATIVE me nr. të llogarisë 1000501000045681.

¹⁰ Gjatë leximit të tabelës ju duhet referuar letrës së harmonizimit e cila është dorëzuar më datën 9 Janar 2015, letrës së dorëzuar për deponimin e mjeteve për regjistrim si të hyra nga vitet e kaluara më datën 28 Shtator 2015, Pasqyrës Kryesore të Hyrave të Dedikuara faqe nr. 20 tabela 14 dhe faqe nr. 9 tabela 8 – Raporti i Avanseve të Pambyllura dhe Huave.

Më poshtë është përmbledhja e natyrës së ndarjeve buxhetore nëpërmjet të hyrave të dedikuara të AKP-së:

Klasifikimi Ekonomik	Janar - Shtator 2015	Janar - Shtator 2014	Janar - Shtator 2013
	HD	HD	HD
Paga dhe rroga	3,886,391	3,500,000	3,500,000
Mallra dhe shërbime	2,630,658	3,507,873	4,200,000
Shërbime komunale	98,000	98,000	98,000
Subvencionet dhe Transferet	116,334	80,000	80,000
Shpenzime kapitale	80,000	160,000	170,000
Gjithsej	€ 6,811,383.00	€ 7,345,873.00	€ 8,048,000.00

Vlera prej ¹¹EUR 6,811,383 është vlera e buxhetit fillestar dhe përfundimtar deri më 30 Shtator 2015.

3.1 Kërkesa e AKP-së dhe buxheti i aprovuar për Paga dhe Mëditje për vitin 2015

Në Ligjin e aprovuar të Buxhetit për vitin 2015 numri i stafit prej 258 është aprovuar ndërsa shuma e fondeve të kërkuara, gjegjësisht buxheti i kërkuar prej EUR 4,273,837.00 për paga dhe mëditje nga Ministrisë së Financave (MF) nuk është aprovuar në tërësi. Buxheti i aprovuar për këtë kategori është EUR 3,886,391.00 dhe ky buxhet, siç e kemi njoftuar edhe MF nuk mjafton të realizohen pagat për të gjithë numrin e stafit të planifikuar dhe aprovuar të AKP-së deri në fund të vitit 2015.

Përmes kërkesës buxhetore për vitin 2015 drejtuar Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave më datën 21 Tetor 2014 kemi kërkuar që buxheti për paga dhe Mëditje (paga e rregullt me kontribut pensional) të jetë gjithsej 4,273,837€, kurse numri i të punësuarve të jetë gjithsej 258 Zyrtarë (kemi bërë zbritjen e numrit të stafit nga 271 në 258).

Shuma e mjeteve të kërkuara për transfer në kategorinë e pagave ka qenë:

1. Pagat e rregullta me kontribut pensional 387,446€
 2. Përvoja e punës sipas Marrëveshjes Kolektive të Kosovës 174,837€.
- Gjithsej: 562,283€.

¹¹ Shih Faqe nr. 1 Tabela 1 Raporti i ekzekutimit të Buxhetit (Grandi Qeveritar, Donatorëve dhe Të hyrat e Dedikuara) dhe faqe nr. 17 Tabela 12 Raporti mbi ndryshimet mbi ndarjet buxhetore në të hyrat e dedikuara.

Përgatitur nga: A.S. dhe K.L.

pas aprovimit të Ligjit të Rishikimit (Ligji Nr. 05/L-046) kemi vërejtur se kërkesa e AKP-së për transferin e mjeteve nuk është aprovuar, çka nënkupton se buxheti për paga dhe mëdijtje ende mbetet i mangët dhe nuk do të mjafton të realizohen pagat për të gjithë numrin e stafit të planifikuar dhe aprovuar të AKP-së deri në fund të vitit fiskal 2015.

Mbesim me shpresë që Ministria e Financave do ta plotëson diferencën e buxhetit për paga dhe mëdijtje duke realizuar transferin e iniciuar nga AKP-ja gjatë procesit të rishikimit.

Gjithashtu nga Ministria e Financave dhe Buxhetit është aprovuar ndarë gabimisht shuma prej »EUR 297,252.00. Kjo shumë është më e madhe se kërkesa e Agjencisë për kategorinë Mallra dhe Shërbime

3.2 Procesi i Rishikimit Gjysmë Vjetor për ndarjet buxhetore nga të hyrat e dedikuara (Ligji Nr. 05/L-046)

për të pasur një planifikim sa ma të mirë të buxhetit, Departamenti i Financave dhe Buxhetit me 28 Maj 2015 ka mbajtur dëgjime buxhetore me Mbajtesit e Buxhetit/Udhëheqësit e Departamenteve brenda AKP-së, ku janë shqyrtuar edhe:

- Shpenzimet e buxhetit deri me 25 Maj 2015;
- Kursimet e mundshme të buxhetit të pas periudhës të sipër shënuar deri në përfundim të vitit 2015;
- Transferet brenda/në mes të programeve buxhetore nga Departamenti i Ligjor në Njësinë e Riorganizimit dhe Administrimit të NSH-ve;
- Nevojat shtesë buxhetore që duhet identifikuar gjatë procesit të rishikimit gjysmë vjetor 2015;

Gjatë procesit të Rishikimit gjysmë vjetor të buxhetit për vitin 2015, ne kemi analizuar të gjitha shpenzimet dhe kursimet e mundshme deri në fund të vitit fiskal 2015 dhe për të eliminuar mungesën e buxhetit të pagave kemi kërkuar transferin e mjeteve të kursyera nga programet tjera buxhetore prej kategorisë Mallra dhe Shërbime në kategorinë e Pagave dhe Mëdijtjeve në programin e Administratës Qendrore.

Më datën 3 Qershor 2015 në Ministrinë e Financave kemi dërguar shkresën për planin rishikimit të buxhetit 2015 përmes së cilës kemi kërkuar:

- Transfer të mjeteve në programin e Administratës Qendrore (kodi 229) në kategorinë Paga dhe Mëdijtje në shumë prej EUR 562,283. Shuma shtesë e kërkuar (për arsye të mos aprovimit në tërësi të kërkesës buxhetore të AKP-së nga MF) është planifikuar për të mbuluar shpenzimet për pagat e rregullta me kontribut pensional gjithsej 387,446€, si dhe shuma prej 174,837€ për përvojën e punës e cila ka filluar të zbatohet nga muaji Maj 2015.
- Transfer të mjeteve në programin e Riorganizimit dhe Administrimit të NSH-ve (kodi 232) në kategorinë e Subvencioneve në shumë prej 10,000 shtesë.

Më miratimin e Ligjit të Rishikimit nga Qeveria, kërkesa e AKP-së për transfer të mjeteve në kategorinë e pagave nuk është aprovuar. Nga MF është aprovuar vetëm transferi i shumës prej ¹³EUR 10,000 në kategorinë ekonomike të subvencioneve.

¹² Shih faqe nr. 24 Tabela 12 – Pasqyra e Departamentit të Administratës Qendrore Nën vijë buxhetore AQ32.

3.3 Transferet/Rialokimet në mes programeve dhe kategorive buxhetore të AKP-së

Pas procesit të rishikimit gjysmë vjetor në programin buxhetor të Riorganizimit dhe Administrimit të Nsh-ve kemi pasur nevojë për ¹⁴transfer nga programet tjera buxhetore në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime si dhe në kategorinë e Subvencioneve.

Arsyeja e mungesës së mjeteve në këtë program buxhetor është vendosja e Nsh Miniera e Goleshit "MIM Golesh" nën Administrim Direkt e cila nuk ka mundur të vendoset në procesin e Likuidimit dhe për të cilën kemi ri-programuar planifikimin e shpenzimeve deri në fund të vitit fiskal 2015.

Transferet nga programet tjera në programin e Riorganizimit dhe Administrimit të Nsh-ve janë gjithsej EUR 79,229 të ndara në dy kategori ekonomike, ¹⁵transferet nuk ka tejkaluar 5% e ndarjeve buxhetore të programeve përkatëse nga të cilat janë transferuar/rialokuar mjetet.:

- Mallra dhe Shërbime prej EUR 52,895.
- Subvencione prej EUR 26,334.

Shënimi 4: Grantet e përcaktuara të donatorëve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në vitet paraprake ka pranuar grante nga donatorët. Grantet nga donatorët kanë qenë të dedikuara për mbulimin e pagave të stafit të AKP-së. Mirëpo, nga viti 2012 e deri më 31 Dhjetor 2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar donacione. Gjatë vitit 2014, mbullimi i shpenzimeve për paga dhe mëditje për stafin e AKP-së është realizuar vetëm nga të Hyrat e Dedikuara.

Shënim 5: Fondi nga huamarriet

Sa i përket huazimeve, Agjencia Kosovare e Privatizimit nga që nga themelimi i saj nuk është e përfshirë në aktivitetet të tilla.

Shënim 6: Pranimet tjera

Përfaqëson vlerat e pagesave të bëra nga pala e tretë jashtë Qeverisë apo Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ku si përfitues ka qenë Agjencia Kosovare e Privatizimit. Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2015, Agjencia nuk ka përfituar shërbime në interes të saj e që janë paguar nga pala e tretë (referoju edhe shënimin 1.3).

¹³ faqe nr. 15/17 Tabela 10 Raporti mbi ndryshimet mbi ndarjet buxhetore në të hyrat e dedikuara tek pjesa Riorganizimi dhe Administrimi i Nsh-ve.

¹⁴ Shih faqe nr. 23 Tabela 16 - Raporti i transfereve në mes të Programeve Buxhetore.

¹⁵ Shih nenin 13.2 të Ligjit nr. 05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe nenin 30.1 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Shënim 6a: Fondet në mirëbesim të AKP-së

Një kopje e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim i dorëzohet Drejtorit të Thesarit së bashku me pasqyrat financiare të buxhetit.¹⁶ Të gjitha llogaritë e mirëbesimit mbahen si llogari bankare të veçanta (të ndara) në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Ndërsa në bankën Procredit dhe Raiffeisen mbahen të hapura llogaritë që mbajnë gjysmën e kapitalit themeltar të Ndërmarrjeve të Reja të cilat vendosen në proces të privatizimit me "spin off" të rregullit dhe llogaritë për afatizimin e mjeteve në depozita kohor (një llogari në Raiffeisen Bank).

Për detaje lidhur me fondet në mirëbesim, lexuesit e pasqyrave financiare të buxhetit vjetor të Agjencisë duhet t'u referohen pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim dhe shënime shpjeguese përkatëse.

Në pasqyrat financiare të buxhetit vjetor të AKP-së është bashkëngjitur tabela e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim ku paraqiten shpenzimet e bëra për pagesën e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për çështje të likuidimit sipas¹⁷ rezolutës të Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 21 Qershor 2012. Gjithashtu janë paraqitur dhe¹⁸ tabelat e rrjedhës së parasë të fondeve në mirëbesim në BQK dhe bankat komerciale.

Që nga Tetor i vitit 2012 kanë filluar pagesat¹⁹ ndaj "Deloitte" e cila e është kontraktuar në Korrik 2012 për të ofruar shërbime profesionale si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile. Deri më datën 30 Shtator 2015 pagesat e realizuara kundrejt vlerës së kontraktuar janë si mëposhtë:

Përshkrimi	Vlera e kontraktuar	Pagesat e realizuara	Shuma e mbetur	% e shpenzimeve /vlerës së kontraktuar
Kostoja fikse	4,912,036.00	3,192,823.40 €	1,719,212.60 €	65.00%
Kostoja variabile	15,008,268.00	7,364,962.46 €	7,643,305.54 €	49.07%
Gjithsej	19,920,304.00	10,557,785.86	9,362,518.14 €	53.00%

¹⁶ Shih të Shënimi nr. 4 i Shënimeve Shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

¹⁷ Shih të Shënimi nr. 10 i Shënimeve Shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

¹⁸ Shih faqen nr. 3 Tabela 3 Rrjedha e parasë së gatshme.

¹⁹ Shih faqe 4 Tabela 4 e Përmblidhje e Pagesave ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale. Shpalosjet detaje janë në shënime shpjeguese nr. 13 të Shënimeve Shpjeguese të Fondeve në Mirëbesim.

Shënim 7: Paga dhe rrogat

Për periudhën Janar – Shtator 2015, burim i financimit dhe i pagesave për paga dhe rroga janë Të Hyrat e Dedikuara. Burime të tjera të tilla si Grandi Qeveritar dhe Grandet e Donatorëve gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur.

	Janar - Shtator 2015					Totali	Janar - Shtator 2014		Janar - Shtator 2013
	GQ	THD	GPD	FH	€		€	€	
përshkrimi	€	€	€	€	€				
Pagesat									
Pagat neto përmes listës së pagave	-	2,677,798.43	-	-	2,677,798.43		2,382,974.54	1,852,810.91	
Pagesa për sindikatë	-	-	-	-	-		-	-	
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-	-	-	-	-		-	-	
Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	-	-	-	-	-		-	-	
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	-	242,502.81	-	-	242,502.81		208,669.70	156,714.71	
Kontributi pensional – punëtori	-	153,700.75	-	-	153,700.75		136,402.42	105,692.93	
Kontributi pensional - punëdhënësi	-	153,700.75	-	-	153,700.75		136,402.44	107,693.98	
Gjithsej pagesat	-	3,227,702.74	-	-	3,227,702.74		2,864,449.10	2,222,912.53	

 - Palëve të treta nëpërmjet publikimit të tyre në uebfaqen zyrtare të Agjencisë në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht;
- Raportimet mujore në Ministrinë e Financave për faturat e papaguara;
- Raporti i blerjeve mbi EUR 500.00 për vitin 2014 ndaj Administratës Tatimore të Kosovës; dhe
- Raportime të tjera sipas kërkesave nga palët me interes

1.5 AKTIVITETET TJERA

- Harmonizimi mujor i listës së pagave për periudhën Janar – Shtator 2015 me Ministrinë e Administratës Publike;
- Inkasimet ditore për telefoninë fikse dhe mobile. Këto inkasime janë për shpenzimet që kanë tejkaluar limitet të cilat i mbulon Agjencia sipas politikave për telefoni fikse dhe mobile. Vlen të theksohet se pas propozimit nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit është marrë vendim nga Menaxhmenti për ndalesë në 50% të pagës bruto për obligimet e papaguara deri në periudhën 30 Qershor 2015;
- Është duke u mbajtur trajnimi për pesë punonjës të Departamentit të Financave dhe Buxhetit në trajnimin e organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës “Vlerësues i Pronave të Paluajtshme”;

1.6 PASURITË

Pasuritë e Agjencisë të blera nga fondet e buxhetit dhe pasuritë e dhëna donacion janë mbajtur në përputhje me Rregulloren nr. 02/2013 të Ministrisë së Financave. Detaje lidhur me pasuritë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese.

1.7 AUDITIMET

- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar raportin e auditorit për Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2014 për buxhetin vjetor. ZAP-i ka dhënë opinion të modifikuar lidhur me çështjen e pagesave për Autoritetin e likuidimit. Agjencia ka paraqitur me shkrim ZAP-it argumentet dhe mospajtimet lidhur me këtë opinion.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm të AKP-së (NJAB) ka filluar auditimin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit për periudhën Janar 2013 – 31 Maj 2015. Raporti Final pritet të dorëzohet pas përfundimit të auditimit, përderisa është përpiluar Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së.

2. FONDET NË MIRËBESIM

2.1 PASQYRAT FINANCIARE

- Pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin fiskal 2014 janë përgatitur dhe janë dorëzuar më 30 Janar 2015 në Sekretariatit e Bordit të Drejtorëve dhe në Ministrinë e Financave;
- Pasqyrat financiare 9 mujore për Fondet në Mirëbesim për periudhën Janar – Shtator 2015 janë përgatitur dhe dorëzohen brenda afatit ligjor në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Sekretariatit e Bordit të Drejtorëve;

2.2 BUXHETI

Buxhet për Fondet në mirëbesim është për ndërmarrjet shoqërore të cilat hyjnë në likuidim. Janë gjithsej 462 Ndërmarrje Shoqërore të cilat kanë hyrë në likuidim. Buxheti përfshinë periudhën që nga hyrja e Ndërmarrjes në likuidim e deri në përfundim të saj.

Përgatitja e buxhetit të fondeve në mirëbesim për NSh-të në likuidim është jashtë kompetencave të Departamentit të Financave dhe Buxhetit, por që ka filluar të jetë pjesë e procesit të monitorimit dhe kontrollit që nga mbledhja e muajit Gusht 2014 të bordit të drejtorëve, kjo sipas kërkesave të ZDM – Likuidimi në mënyrë që të rritet cilësia, plotësia dhe zvogëlimi i rrezikut të tejkalimit të buxhetit;

Buxheti i NSh-ve i shpenzuar deri më 30 Shtator 2015

Buxheti	GJITHSEJ SHPENZIMET	Buxheti i mbetur	% e shpenzimeve
12,946,936.95	4,638,326.93	8,308,610.02	35.83%

2.3 PROCESIMI I PAGESAVE

- Procesimi i 7,710 transakcioneve dalëse të fondeve në mirëbesim në BQK dhe harmonizimi i 13,102 transakcioneve (hyrëse dhe dalëse) nga fondet në mirëbesim.

2.4 RAPORTIMET

- Harmonizimi me Bankën Qendrore të Kosovës dhe raportimet në baza mujore të raporteve për pasqyrat financiare për Fondet në Mirëbesim ndaj:
 - Menaxhmentit dhe Drejtorëve;
 - Zyrave Rajonale dhe Autoritetit të Likuidimit - Raporteve Përmbledhëse të Llogarive të Likuidimit dhe Kartelave bankare. Raportimi në baza mujore përfshinë periudhën Janar deri më 30 Shtator 2015. Raportet janë paraqitur dhe në uebfaqen e AKP-së (në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze); dhe
 - Palëve me interes përmes publikimit në uebfaqen zyrtare të Agjencisë në gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze.

2.5 INVESTIMET E FONDEVE NË MIRËBESIM

Sa i përket investimeve të fondeve në mirëbesim, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e orientuar në tregun e investimeve afatshkurtra siç janë depozitat deri në dymbëdhjetë muaj (12) në Bankën Qendrore të dhe bankat komerciale të Kosovës si dhe në letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e thesarit).

Ministria e Financave më datën 7 Shtator 2015 më ka themeluar komisionin për projekt ligjin për plotësim dhe ndryshimin e ligjit 04-L/034 mbi AKP-në. Pjesë e diskutimit të këtij komisioni është edhe zgjerimi i kornizës ligjore (shtesë neni 19A) mbi Agjencinë rreth investimeve të fondeve në mirëbesim. Përveç afatizimeve të sipër shënuara. Shkurtimisht, po i paraqesim propozimet e Komisionit:

- Afatizimi i mjeteve në bankat komerciale edhe jashtë Kosovës;
- Letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga Qeveria e Kosovës apo shtet tjetër sovran;
- Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga ndonjë Korporatë me seli në ShBA apo të ndonjë shteti të Bashkimit Evropian;
- Fonde të tregtuara në berzë (Exchange Traded Funds), ose fonde të përbashkëta (Mutual Funds); dhe
- Marrëveshje të ri-blerjes që kanë për bazë letra me vlerë të përcaktuara sipas pikave të sipër shënuara

2.5.1 Afatizimi i mjeteve në depozita kohor

Gjatë vitit 2015, interesi i fituar është prej EUR 5,000 nga afatizimi i mëposhtëm:

1. Një depozit në depozita dymbëdhjetëmujor, gjithsej në shumën totale prej 5,000,000.00 që ka maturuar më 5 Korrik 2015.

Gjatë periudhës Janar – Shtator 2015. Agjencia nuk ka qenë aktive në këtë treg, për shkak të normave tepër të ulta të interesit. Në disa raste norma e interesit ka qenë negative si p.sh. me MINUS 20%.

2.5.2 Investimi i letrave në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e Thesarit) kohor

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e datës 21 Qershor 2012 ka marrë vendim që Menaxhmentit t'i lejohet diskutimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit do të mundësonte investimin e fondeve në mirëbesim në tregun primar dhe tregtimi i tyre në tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria.

Deri më tani nuk bërë ende ndonjë investim ose pjesëmarrje në ofertat e letrave me vlerë të Qeverisë, për shkak se, nuk është përfunduar me sukses përpjekja e Agjencisë për këto investime për arsyet të cilat nuk janë të njohura për Agjencinë.

2.6 AKTIVITETET TJERA

- Departamenti i Financave ka rritur cilësinë e raportimit të fondeve në mirëbesim sidomos për sa i përket Buxhetit të shpenzuar të NSh-ve në likuidim. Zyret Regjionale janë më të informuar rreth shpenzimeve të buxhetit të NSh-ve në likuidim;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka krijuar metoda rreth procesimit të pagesave të tatimeve për të hyrat e realizuara të NSh-ve në likuidim. Brenda afatit ligjor kohor procesohet një numër i madhë i pagesave të tatimit për të hyrat e realizuara të qirave nga akitiveti i NSh-ve, tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh). Këto pagesa bëhen menjëherë të njohura në Administratën Tatimore të Kosovës, pagesa të cilat në ATK janë idenfitikuar me vonesë.
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka asistuar rreth databazës së faturimit për dhënien me qira të aseteve; dhe
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka qenë pjesëmarrës rreth krijimit të procedurave për angazhimin e ofruesve të shërbimeve.

2.7 DETAJE TJERA LIDHUR ME AKTIVITETET FINANCIARE TË AGJENCISË

Detaje tjera lidhur me aktivitetet financiare të Agjencisë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Buxhetit Vjetor dhe në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

8.9. DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor (tutje DL) ofron shërbime ligjore për aktivitetet e Agjencisë përfshirë privatizimin, likuidimin, prokurimin dhe rastet specifike të Trepçës.

Departamenti është ndarë në njësi punuese të organizimit, ndarjes së punëve dhe përgjegjësi me qëllim të realizimit në mënyrë efikase dhe efektive në tërësi të objektivave dhe përgjegjësi të Departamentit Ligjor dhe të cilat janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e përgjithshme të AKP-së.

Në vijim janë sqaruar aktivitetet bazuar në sipas njësive në Departamentin Ligjor:

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë (NjPGj).
2. Njësia për Opinione Ligjore (NjOL).
3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA).
4. Sekretariati i KSHALP-së: Për shqyrtimin e ankesave për 20 %.
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP).

Departamenti Ligjor shërben si ombrellë për Komisionin Shqyrtues për Ankesat e Listave të Punëtorëve (KShALP), megjithëse ky komision vepron në mënyrë autonome dhe i raporton vetëm Bordit të Drejtorëve të Agjencisë.

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë (NjPGj)

Gjatë periudhës Janar – Shtator janë pranuar gjithsej 337 lëndë ndërsa për veprimet procedurale në lëndë për periudhën në fjalë janë ndërmarr këto veprime:

- 233 Mbrojtje në padi, 59 Kundërpërgjigje, 34 Përgjigje në masë të përkohshme 14, Ankesa, 25 Përgjigje në ankesa, 23 Parashtresa, 11 Përgjigje në përgjigje të ankesave, 68 Seanca Gjyqësore dhe 28 Përgjigje në urdhër.

Sa i përket çështjeve lidhur me listat e punëtorëve të NSH-ve, gjatë periudhës Janar – Shtator janë pranuar gjithsej 438 lëndë kurse veprimet e ndërmarra në lëndë për këtë periudhë janë si më poshtë:

- 46 Përgjigje në Urdhra, 1 Pjesëmarrje në seancë gjyqësore, 150 Aktgjykime, 40 Aktvendime, 144 Përgjigje në ankesa dhe 58 Parashtresa.

2. Njësia për Opinione Ligjore (NjOL)

Njësia e Opinioneve Ligjore (NjOL) ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, por që kryesisht konsistojnë në dhënien e mendimeve dhe këshillave ligjore, hartimin e dokumenteve juridike, rregullore apo akte tjera juridike, si dhe pjesëmarrjen në takimet e ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe raportuese NjOL ka kontribuar në performancën e Agjencisë duke dhënë afërsisht 22 opinione ligjor sipas 'Kërkesave për Veprim' të njësive dhe departamenteve por edhe Menaxhmentit të Agjencisë.

Krahas opinioneve ligjore, sipas nevojës NJOL ka hartuar apo ka marrë pjesë në hartimin, shqyrtimi apo analizimin e mëse 24 dokumenteve të ndryshme, si rregullore të brendshme, vendime, kontrata, letër-përgjigje, kërkesa, etj.

3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA)

Gjatë kësaj periudhe 9 mujore 1 Janar- 30 Shtator Njësia për ankesa e Departamentit Ligjor ka regjistruar dhe proceduar rreth 538 kërkesa /lëndë të reja dhe 1.504 dokumente/ parashtresa shtesë lidhur me lëndët e regjistruara me herët; gjithsejtë janë pranuar **2.118** parashtresa.

218 Njoftime sipas nenit 29 dhe 30 të Ligjit të AKP-së.

220 Kërkesa lidhur me likuidimin ose ndaj NSH-ve në likuidim.

3.539 Dokumente nga kopjet fizike të lëndëve të ndryshme janë radhitur sipas regjistrimit në sistem.

563 parashtresa me kopje të mjaftueshme janë dorëzuar për gjykatë në zyrën e protokollit.

1.814 fajllime lidhur me lëndët gjyqësore të Njesisë së përfaqësimeve dhe parashtresa të ndryshme, të cilat janë dorëzuar tek zyrtarët kompetent.

3.044 protokollime interne në Librin intern të protokollit të Njesisë për ankesa, të dokumenteve hyrëse dhe dalëse.

Koordinimi në baza ditore me Gjykatë/DHPGJSK , me Zyrën e Protokollit të AKP-së dhe me Autoritetin e Likuidimit, me qëllim të procedimit të drejtë dhe të saktë të lëndëve gjyqësore, me qëllim të monitorimit dhe respektimit të afateve ligjore.

Aktivitete tjera në ndihmë të njësive dhe departamenteve tjera të Agjencisë.

Select Date Logged Range: 1/1/2015 9/30/2015 Go

Drag a column header here to group by that column		
#	Number of Claims	Claim Type
	2	A = Ownership of SOE
	158	B = Ownership of SOE asset
	144	Banesat
	31	D = Creditor (unsecured)-wages
	34	E = Creditor (unsecured)-other
	20	G = Other
	3	H = Rules of Tender
	146	I = Workers List
Total Sum=538		

4. Sekretariati i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Listat e Punëtorëve (KSHALP) për 20%

Për këtë periudhë, Sekretariati i KSHALP-së ka punuar rreth shqyrtimit të ankesave të pasafatshme për ndërmarrjet e poshtë shënuara:

- NSH “ IBG –Bateria ” në Gjilan
- NSH “ Bankkos ” në Prishtinë.
- NSH “ Ratko Mitrovic - Kulla” në Prishtinë.
- NSH “ Vreshtaria ”- Landovicë - Prizren
- NSH “ Prizren Market ” në Prizren.
- NSH “Qumështorja Konsume” Fushë Kosovë/ZR Prishtinë
- NSH “Liria” Prizren/ZR Prishtinë
- NSH “28 Nëntori” - Gjilan
- NSH “Mekanizimi” Prishtinë/ZR Prishtinë
- NSH “Rilindja” në Prishtinë/ZR Prishtinë
- NSH “Industria Ushqimore’ në Prizren/Prizren
- NSH “Ramiz Sadiku” Prishtinë/ ZR Prishtinë

Janë zhvilluar takime të rregullta me palë, është bërë tërheqja e kopjeve të dokumentacionit nga ana e punëtorëve për NSH “ Drenica ” etj.

5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP) për 20%

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të punëtorëve (KSHALP) është themeluar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë në Muajin Shtator 2011, në përputhje me nenin 10,pika 10.4 të Politikave Operuese dhe është organ i pavarur, i brendshëm për shqyrtim administrativ të ankesave në listat e punëtorëve për 20%-in. Përderisa për vendimet e veta Komisioni i raporton Bordit të Drejtorëve, në anën operacionale është njësi organizative e Departamentit Ligjor. KSHALP asistohet nga Sekretariati e cila është poashtu njësi e Departamentit Ligjor dhe është përgjegjës për mbështetjet të KSHALP-së në ofrimin e asistencës së nevojshme në bashkëpunim dhe sipas udhëzimeve të Kryesuesit të KSHALP-së.

Gjatë periudhës raportuese, KSHALP ka qenë i angazhuar si në vijim:

- Takimet me palë për sqarim për mospërfshirjen e tyre në listat finale lidhur me 20%.
- Kryesuesi i KSHALP-së, është i angazhuar në analizën ligjore të Rregulloreve në fuqi.
- Angazhimi i Kryesuesit të KSHALP-së, si anëtar i rasti në pesë (5) raste të KZKA-së.
- Zyrtarja Ligjore-Anëtarja e KSHALP-së, është e angazhuar si Kryesuese e Komisionit në KZKA dhe Anëtare e Komisionit për KPS.

8.10. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës ka për detyrë të ofroj kushte sa më të mira njerëzore, infrastrukturore dhe logjistike për arritjen e objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto njësi: Njësia e Burimeve Njerëzore, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Protokollit, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Arkivit, Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Zyra e Transportit.

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese në Njësinë e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

Pagat:

- Është bërë azhurnimi dhe konfirmimi, si dhe janë dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave (Payrollit) për muajt: Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht dhe Shtator 2015.

Personeli:

- Është finalizuar Procesi i Rekrutimit dhe Selektimit për 6 (gjashtë) pozita të lira:
 - o Zyrtar për Likuidim ZR Pejë, ZR Mitrovicë dhe ZR Gjilan;
 - o Zyrtar Ligjor ZR Pejë;
- Është finalizuar Procesi i Rekrutimit dhe Selektimit për 4 (katër) pozita zëvendësuese:
 - o Vozitës;
- Ka dhënë dorëheqje 1 (një) punonjës;
- 4 (katër) punonjës në pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës;
- 1 (një) rast i shkëputjes së marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit sipas moshës (65 vjet);
- Me rastin e hetimeve të disa zyrtarëve të AKP-së, janë përgatitur vendimet për pezullim parandalues për 4 (katër) zyrtarë të AKP-së.
- Me rastin e emërimeve funksionar publik, kanë pezulluar marrëdhënien e tyre të punës 3 (tre) zyrtarë të AKP-së;
- Pas mbarimit të periudhës së pezullimit të dakorduar, janë kthyer në punë në pozita ekuivalente 2 (dy) zyrtarë të AKP-së.

Zhvillimi i stafit:

- Në bazë të Planeve Individuale të Zhvillimit të punonjësve, është përgatitur Plani Vjetor i Agjencisë për Trajnim dhe Zhvillim të punonjësve për vitin kalendarik 2015;
- Është koordinuar pjesëmarrja në Trajnimet e mëposhtme:
 - o Programi Certifikues “Vlerësues i Pronave” për 40 zyrtar të AKP-së;
 - o Trajnimi SCAAK për 3 zyrtarë të AKP-së;

- o Trajnimi Motion Graphics për 1 (një) Zyrtar për Eëb Design ;
- o Trajnimin “Digital Marketing – Search Marketing” për 1 (një) zyrtar të AKP-së;
- o Trajnimi Executive Assistant Masterclass për dy (2) zyrtar të AKP-së;
- o Trajnimi për Provim të Jurisprudencës) për katër (4) zyrtar të AKP-së;
- o Trajnim për CISCO për një (1) zyrtar të AKP-së;

Procesi i Menaxhimit të Performancës:

- Ka përfunduar mbledhja e vlerësimeve të performancës për vitin 2014, planet individuale të punës si dhe Planet Individuale të Zhvillimit për vitin 2015 të punonjësve (përpilimi i Udhëzuesit Intern të Agjencisë mbi Menaxhimin e Performancës, modifikimi i formularëve relevant, informimi/ këshillimi dhe pajisja e punonjësve me të njëjtat, kolektimi, selektimi, popullimi i bazës së të dhënave, kalkulimi i mesatares në baza individuale si dhe përgatitja e raportit vjetor);

Raportimet:

- Është përpiluar dhe dërguar në DASHC/ MAP, pyetësori për të dhënat në shërbimin civil të AKP-së për vitin 2014;
- Është përgatitur pyetësori vetë-vlerësues për MFK;
- Është ripërpiluar raporti mbi Planin e Personelit të AKP-së për vitin 2015 sipas Formularit të azhurnuar sipas kërkesës së MAP-it dhe i njëjti është ri dërguar në DASHC/MAP;
- Përgatitja e raportit për finalizimin e procesit 3 vjeçar lidhur me Kualifikimin Akademik të punonjësve të Agjencisë;
- Përgatitja dhe dërgimi i listës së Zyrtarëve të Lartë të AKP-së për deklarim të pasurisë në Agjencinë kundër Korrupsion;
- Është dorëzuar Raporti preliminar mbi Procesin e Vlerësimit të Performancës në Punë për periudhën Janar – Dhjetor 2014;
- Janë dërguar në KPMSHC, komentet në Raportin e KPMSHC gjatë vizitës së tyre në shtator 2014;
- Është finalizuar dhe dërguar në Ministrinë e Administratës Publike përvoja e punës për stafin e AKP-së;

Çështje të tjera:

- Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar dhe ka marr vendim për **34 (tridhjetekatër)** ankesa ;
- Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe ka marr vendim për **1 (një)** rast;
- Komisioni për Rishikim të pagës ka shqyrtuar dhe ri-shqyrtuar **33 (tridhjetetre)** kërkesa të zyrtarëve të AKP-së;
- Janë shqyrtuar dhe finalizuar azhurnimet e një numri të madh të Përshkrimeve të Punës së:
 - o Sekretaria Ekzekutive e Bordit të Drejtorëve;
 - o Njësia për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë;
 - o Departamenti i Koordinimit të Likuidimit;
 - o Njësia e Teknologjisë Informative;
 - o Departamenti i Administratës;
 - o Departamenti Ligjor;

- o Njësia për Menaxhimin e Projektit të Likuidimit.
- Janë përgatitur Deklaratat nën betim si dhe Vendimet përkatëse për 258 punëtorë të AKP-së për përvojë pune (mbledhja e të gjitha dëshmive për përvojë pune në dosje fizike të zyrtarëve dhe bashkëngjitja në Deklaratën nën betim) dhe për të njëjtat është njoftuar Ministria e Administratës Publike.

NJËSITË TJERA TË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit paraqiten për njësitë: **Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme, Njësia e Arkivit, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Protokollit dhe Zyra e Transportit.**

Njësia e Përkthimeve:

- Njësia e Përkthimeve ka përkthyer **334 dokumente** me **3,197 faqe** dhe ka siguruar përkthyesit për **14 takime**.

Njësia e Protokollit:

- Gjate kësaj periudhe janë pranuar si dokumente hyrëse në këtë zyre **3082** shkresa;
- Shkresa dalëse nga kjo zyre janë regjistruar **2634**;
- Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë **5719**;
- Të skanuara **5719**;
- Pranimi me Post **715**;
- Dërgimi me Post **1158**;
- Dërgimi me Libër Personal brenda AKP-së **3082**;
- Dërgimi me Libër jashtë AKP-së **189**;

Njësia e Teknologjisë Informative:

- Si veçanti e kësaj periudhe është migrimi total i upgrade të PC që kanë qenë në sistem të vjetër ĒINDOËS XP, i cili në tërësi ka përfunduar në muajin Mars;
- Vendorsja e masave parandaluese për mbrojtjen nga programet e shkarkuara nga interneti; Vendorsja e dokumentimit fizik të kontrollit javor për:
 - funksionimin e replikimit;
 - update të antivirusit;
 - funksionalitetit të e-mail serverit
 - kontrollit të blacklistës; dhe
 - GSM testimit të Alarmit në Server Room dhe recovery center

- Për te minimizuar rrezikun nga viruset dhe prishjes së disqeve nga puna e pandërprerë, kompjuterët janë programuar te ndalen pas orarit te punës. Ndalja e kompjuterëve pas orarit të punës po tregohet shumë e suksesshme në përmirësimin e punës së kompjuterëve dhe aplikimit të updata-ve. Përveç minimizimit të rrezikut nga sulmet e jashtme dhe prishjet eventuale , është konstatuar **kursim i konsiderueshëm i energjisë elektrike** (të dhënat nga fakturat e rrymës);
- Procedurat e tenderit janë iniciuar me sukses dhe është përmbush plani vjetor i lidhur me blerjen e shërbimeve apo pajisjeve të TI-së;
- Është arritur një marrëveshje në mes të BQK-së dhe AKP-së mbi ruajtjen e dokumentacionit elektronik të AKP në kuadër të marrëveshjeve kornizë që ka BQK-ja në ruajtjen e aseteve të klientëve.

Sfidat:

- Përpilimi i strategjisë për ruajtjen e arkivave të e-mail-ave të cilat gjenden në kompjuterët lokal , me qëllim të backup-it në rast të dështimit eventual te Diskut ende mbetet sfidë , pasi që duhet një analizë e thellë e softuerëve të përshtatshëm për implementim të suksesshëm. Jemi në proces të përgatitjes për vitin 2016 të softuerit të dëshiruar për implementim të strategjisë. Për momentin është e pamundur që të gjithë e-mail arkivat të qëndrojnë në server, andaj për të minimizuar humbjet eventuale nga fatkeqësitë harduerike (prishjet e HDD) është e nevojshme që të ballafaqohemi me këtë risk mesatar;
- Në përgjithësi vetëdijesimi i shfrytëzuesve të rrjetit është rritur dhe kemi probleme shumë më të vogla në krahasim me vitet e kaluara. Përpilimit i strategjisë për sensibilizimin e shfrytëzuesve mbi përdorimin adekuat të resurseve të TI-së është në proces dhe është parapare që të prezantohet në formë të ëorkshopi ne të gjitha zyrat e AKP-së;
- Revidimi i politikave të TI-së që të përshtaten nevojave dhe rrethanave të reja të krijuara dhe të jenë sipas standardeve të TI-së. Politikat janë duke u draftuar dhe në momentin e draftit preliminar, do të prezantohet menaxhmentit për diskutim, përmirësim deri në aprovimin e tyre;
- Pavarësisht se temperatura, pluhuri dhe kushtet janë të përshtatshme dhe monitorohen, probleme të vazhdueshme paraqiten në prishjen e komponentëve serverik (disqeve të serverëve) në **Local Recovery Center**. Fatmirësisht kemi pasur zëvendësime në stok që shpejt ta evitojmë problemin. Sapo të arrijnë pajisjet e reja të UPS-ve për server, ne do ti zëvendësojmë UPS që në këtë mënyrë të eliminojmë mundësinë e defekteve në sistemin e furnizimit të rrymës;
- Nëse ky trend vazhdon, Kushtet në **Local Recovery Center** (ana e majtë e ndërtesës) do të identifikohen si Risk Mesatar i cili duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë

Njësia e Arkivit:

- Azhurnim në dokumentacionin e para-kualifikimit të Njesisë së Marketingut;

- Regjistrorë të skanuar, regjistruar dhe arkivuar për Departamentet dhe Njësitë e AKP-së, gjithsejtë 236 regjistror;
- Skanimi dhe arkivimi i Librave të Protokollit të Departamenteve, Njësive, Regjioneve të AKP-së, gjithsej 14 libra Protokollit dhe 14 Libra të Postës;
- Ofrim i ekzaminimit të dokumentacionit arkivor, Departamenteve/Njësive/Regjioneve të AKP-së;
- Regjistrimi i dokumentacionit në programin e Arkivit;

Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme:

- Gjatë kësaj periudhe nëntëmujore kemi asistuar në dëbimin e uzurpatorëve të pronave shoqërore në rajonin e Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës, në gjithsej 92 njësi aty ku është shfaqur nevoja;
- Kemi bërë të gjitha riparimet e kërkuara, si në Zyrën Qendrore po ashtu edhe në Zyrat Rajonale të AKP-së, që në total janë 268 riparime;
- Janë protokolluar 297 fatura, të cilat janë përcjellë në Departamentin e Financave, prej tyre janë futur në freebalance 264 fatura, si dhe janë nënshkruar 142 urdhërblerje ;
- Kemi mbuluar 431 kërkesa për furnizim me material administrativ dhe higjienik;
- Gjatë muajve Prill dhe Maj kemi implementuar projektin e vendosjes së shenjave emergjente në tërë zyrat e AKP-së bazuar në Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe mbushja dhe vendosja në mënyrë profesionale e aparateve kundër zjarrit;
- Kemi iniciuar kërkesën për kontraktimin e një kompanie për mirëmbajtjen dhe servisimin e Air Kondicionerëve, ku pas përfundimit të procedurave nga Prokurimi, kemi bërë servisimin e të gjithë air kondicionerëve që kanë pasur nevojë;
- Në momentin e raportimit, jemi në proces të kontraktimit të një kompanie për servisimin dhe mirëmbajtjen e ngrohjeve qendrore dhe gjeneratorëve nëpër objektet e AKP-së;
- Pas identifikimit të shpenzimeve më të mëdha se që janë zotuar nga Departamenti i Likuidimit në kontratën për ofrimin e shërbimeve të sigurimit fizik, jemi duke përgatitur deklaratën e re të nevojave për kontraktimin e një kompanie për shërbimet e sigurimit fizik;

Zyra e Transportit:

- Gjatë kësaj periudhe 9 mujore kemi pasur 1452 kërkesa për shërbime të rregullta dhe 1222 shërbime-kërkesa urgjente të cilat janë mbuluar po ashtu;
- Në servisim i kemi pasur 73 vetura të cilat janë servisuar dhe vazhdon procesi i servisimit dhe i kontrollimit të të gjitha veturave gradualisht, të kanë nevojë, si dhe kemi futur në përdorim 10 veturat e reja Renault Dacia, të cilat edhe i kemi pajisur me radio dhe me pajisjet tjera përcjellëse (trekëndëshi, rripi tërheqës, llambat rezervë dhe tepihët përcjellës);
- Janë nënshkruar kontratat për furnizimin me karburante për vetura, kontrata për sigurimin e veturave dhe është bërë kontrollimi dhe regjistrimi i të gjitha veturave që i kemi;
- Është bërë çregjistrimi i 8 veturave për shkak të vjetërsisë së tyre dhe gjatë servisimit të disa veturave Clio kemi bërë ndërrimin e pjesëve duke marrë pjesët e këtyre veturave të cilat nuk do të përdorim, me ç'rast janë kursyer dukshëm shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre;
- Kanë filluar punën 4 vozitësit e rinj pas pezullimit të vozitësve tanë i cili pezullim parandalues vazhdon ende dhe nga data 15 Tetor 2015 pa pagesë deri në vendimin e gjykatës.

8.11. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Departamenti i Prokurimit gjatë periudhës raportuese ka nënshkruar 39 kontrata: 34 kontrata, 3 aneks kontrata dhe dy kontrata emergjente duke përdorur të gjitha procedurat e prokurimit: procedura te prokurimit me vlere te madhe, procedura e prokurimit me vlere te mesme, kuotimi me vlere te vogël dhe kuotimi me vlere minimale si dhe procedura e negociuar pa publikim e njoftimit për kontrate.

1. Kontratat me gazetën serbe "Danas"
2. Kontrata me gazetën malaziasë "Vijesti"
3. Anex Kontrate: "Shërbimet e internetit dhe rrjetit të Teknologjisë Informative"
4. Shërbimet e internetit dhe rrjetit të Teknologjisë Informative
5. Anex kontrata "Furnizim me naftë për veturat e AKP-se"
6. Anex kontrata "Furnizim me naftë për gjeneratorë të AKP-se"
7. Vazhdimi i kontratës për objektin me qira në Zyrën Satelitore në Leposaviq
8. Ri tender- Furnizim me karburante për nevojat e AKP-se
9. Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve zyrtare të AKP-se
10. Shërbimet e shtypjes së materialeve promovuese
11. Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve
12. Emetimi i TV reklamave dhe shpalljeve
13. Prodhimi dhe shtypja e biznes kartelave
14. Servisi dhe mirëmbajtja e automjeteve nën garancion DACIA Sandero
15. Furnizim me naftë për ngrohje dhe gjeneratorë (procedurë emergjente)
16. Furnizim me karburante për vetura (procedurë emergjente)
17. Kontrata me Radio 21
18. Kontrata me Radio Dukagjini,
19. Kontrata me Radio Kosovën,
20. Kontrata me Institutin e medieve të Kosovës,
21. Kontrata me Radio Graçanica,
22. Kontrata me Radio Kontakt Plus-në gjuhën serbe
23. Kontrata për Mirëmbajtjen e data bazës së Njësisë për Ankesa të Departamentit Ligjor
24. Ri-Ri tender- Furnizim me derivate të naftës për ngrohje dhe gjeneratorë
25. Mjetet për zerim dhe përkthim simultant
26. Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit dhe furnizim me shenja emergjente
27. Vazhdimi i kontratës për objektin me qira Zyra Shtërpçë
28. Mirëmbajtja dhe furnizimi me Air Kondicioner
29. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative,
30. Furnizim me material Higjienik
31. Furnizim me Material Administrativ
32. Shërbimi i fotokopjimit dhe Printimit, Servisi i pajisjeve të Teknologjisë Informative (TI)
33. Kontrate për shpallje në gazetën ditore: Koha Ditore,
34. Kontrate për shpallje në gazetën ditore: Zëri,
35. Kontrate për shpallje në gazetën ditore: Epoka e Re,
36. Kontrate për shpallje në gazetën ditore: Bota Sot,
37. Kontrate për shpallje në gazetën ditore: Kosova Sot
38. Shërbimi për "Hosting" dhe "Domain Name" për dy faqet e internetit ëëë.pak-ks.org dhe ëëë.ksa-kosovo.org
39. Servisi dhe mirëmbajtja e Ngrohjeve Qendrore dhe Gjeneratorëve

8.12. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) me sukses ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën raportuese, duke i ofruar menaxhmentit të lartë rekomandime konkrete.

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së gjatë kësaj periudhe:

1. **Auditimi i Njesisë për Marrëdhënie me Publikun dhe Medie (NJMPM):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me punën e NJMPM-së, gjegjësisht nëse procesi i shqyrtimit të kërkesave nga palët e jashtme për qasje në dokumentet publike është bërë konform kërkesave ligjore. Ky auditim ka rezultuar me 8 rekomandime përkatëse.
2. **Auditimi i Departamentit të Administratës (DA):** Objektivat e këtij auditimi kryesisht ishin të lidhura me menaxhimin e proceseve, gjegjësisht shfrytëzimin e pajisjeve dhe mjeteve të AKP-së konform rregullativës ligjore, mbulimit të mjaftueshëm ligjor të çështjeve që lidhen me administrimin e proceseve në DA, planifikimin e aktiviteteve dhe detyrave, përkatësisht se puna e realizuar në këtë departament dhe njësitë e tij, është zhvilluar sipas një plani vjetor me objektiva të vendosura dhe të aprovuara nga Menaxhmenti. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 12 rekomandime përkatëse.
3. **Auditimi i Departamentit Ligjor (DL):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar kryesisht në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me Departamentin Ligjor. Ky auditim nuk ka rezultuar me ndonjë të gjetur konkrete, përveç disa konkluzioneve që kemi dhënë në lidhje me procesin në përgjithësi. Si rezultat i kësaj, asnjë rekomandim nuk është adresuar, pasi që mostrat e përzgjedhura për testim nuk kanë rezultuar me ndonjë parregullsi materiale apo procedurale në DL.
4. **Auditimi i Departamentit të Financave (Menaxhimi i Fondeve në Mirëbesim):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me mënyrën e menaxhimit të Fondeve në Mirëbesim, gjegjësisht nëse këto fonde janë investuar duke respektuar rregullat e brendshme si dhe kornizën ligjore në fuqi. Auditimi i Departamentit të Financave, përkatësisht menaxhimit të fondeve në mirëbesim është në fazën e Draft-Raportit, dhe i njëjti pritet të finalizohet në gjatë muajit Tetor.
5. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (ZR e Pejës dhe ZR e Mitrovicës):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me procesin e dhënies së objekteve (lokaleve) me qira në ZR të Pejës dhe ZR të Mitrovicës, implementimin efektiv të vendimeve të Bordit dhe Menaxhmentit nga ana e Departamentit të Koordinimit Rajonal gjegjësisht zyrat përkatëse, si dhe aktivitetet tjera të ndërmarra nga këto zyre. Ky auditim është në proces, dhe i njëjti pritet që të finalizohet gjatë muajit Nëntor.
6. **Auditimi i Departamentit të Prokurimit:** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it, ky auditim ka filluar në fund të muajit Gusht. Auditimi në fjalë është përqendruar në rishikimin e procedurave për aktivitetet e prokurimit publik, duke përfshirë përgatitjen e planit të punës, përgatitjen e dosjes së tenderit, vlerësimin e kontratave publike, specifikimet teknike, reklamimin dhe transparencën, udhëheqjen me procedurat e prokurimit dhe kërkesat mbi përshtatshmërinë, pagesat, përmbarimi i

kontratës, etj. Auditimi i Departamentit të Prokurimit është në proces, dhe i njëjti pritët që të finalizohet gjatë muajit Nëntor.

7. **Hartimi i Strategjisë (2016-2018) dhe Planit të Punës për 2016:** është duke u rishikuar Strategjia e NJAB-it për vitet 2014-2016 dhe e njëjta pritët të amandamentohet për vitet 2016-2018, si dhe është duke u përgatitur Plani Vjetor i Punës për vitin 2016.
8. **Trajnimi i stafit të NJAB-së:** Gjatë periudhës raportuese stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka marrë pjesë në trajnimet/seminaret si në vijim:
 - Trajnimi për Licencimin e Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme;
 - Seminari i organizuar nga OSBE-ja: “Zhvillimi i kapaciteteve të Policisë së Kosovës në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë”;
 - Trajnimi i organizuar nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave për Pamje dhe Raportim në Version e ri - V7.0.

8.13. NJËSIA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Në përputhje me Planin Vjetor të Punës së AKP-së, raporti i Njesisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun për periudhën raportuese përfshinë realizimin e aktiviteteve të parapara për realizimin e objektivave të përgjithshme.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka siguruar përkrahje të plotë në promovimin e punës së Agjencisë, edukimin e publikut në lidhje me punën e Agjencisë si në nivel lokal, ashtu edhe në atë ndërkombëtarë, si dhe hartimin dhe menaxhimin e fushatave specifike të sektorit informativ të AKP-së.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka bërë monitorimin ditor të medieve të shkruara dhe elektronike vendore dhe ndërkombëtare për interes të AKP-së, dhe ka siguruar një përmbledhje të shkrimeve të ndërlidhura me mandatin e Agjencisë të cilinë e shpërndanë në baza ditore për zyrtarët e Agjencisë..

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun është pikë kontaktuese me media në ofrimin dhe sigurimin e komunikimit me media lidhur me aktivitet e Agjencisë, si në pranimin e pyetjeve dhe në përgatitjen e përgjigjeve duke u koordinuar me departamentet/njësitë përkatëse dhe Drejtorin Menaxhues. Njësia ka pasqyruar aktivitetet e Agjencisë tek media dhe opinioni i gjerë, duke prezantuar aktivitetet dhe qëndrimet e Agjencisë në media.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka përgatitur rreth **300** përgjigje me shkrim të dërguara përmes emailit në pyetje të gazetarëve të medieve të ndryshme;

- Prononcime përmes telefonit – Mbi **130** prononcime me telefon;
- Përgjigje dhe prononcime në **Televizione** - (Rreth **50** prononcimet në TV);
- Përgjigje dhe prononcime në **Radio**: Rreth **100** prononcime për Radio vendore dhe ndërkombëtare;

Njësia për Marrëdhënie me Publikun dhe Media, gjatë vitit 2014 ka hartuar dhe dërguar për media dhe përmes tyre tek opinioni i gjerë mbi **20 Komunikata për Media** për aktivitetet e ndryshme të Agjencisë, ndërkaq ka lëshuar **3 Komunikata** në formë sqarimi/reagimi ndaj shkrimeve/deklaratave dezinformuese për Agjencinë.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka vazhduar të populloj ueb faqen e AKP-së me të gjitha informatat në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe procesin e privatizimit në Kosovë.

Marrëdhënie me Publik dhe Qasje në dokumente Publike

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka bërë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në Dokumente Publike, mbajtjen e evidencës së saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente si dhe për numrin e lejuar apo refuzuar të këtyre kërkesave.

Janë përgatitur raporte të rregullta (çdo tre muaj) dhe këto raporte i janë dërguar njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, e cila përgatit raportin gjithëpërfshirëse të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Numri i kërkesave të pranuar 2015					
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E kufizuar	Pa përgjigje	Arsye tjera
14	6	7	1		

8.14 KOMISIONET

Agjencia ka një numër të caktuar të komisioneve të cilat i kryejnë detyrat sipas udhëzimeve të Bordit apo Menaxhmentit.

KOMISIONI I BANESAVE PËR NSH-TË - SHITJA

Komisioni ka regjistruar gjithsejtë **1356** kërkesa për blerje të banesave duke llogaritur nga 01/04/2012, prej të cilave deri me tani nga Bordi i AKP-së janë vendosur 574 kërkesa për shitjen e banesave.

- Gjatë periudhës raportuese nëntë mujore nga Komisioni për Shitjen e Banesave janë shqyrtuar 390 kërkesa për shitjen e banesave. Nga numri i kërkesave të shqyrtuara (390) në mënyrë meritore janë vendosur dhe janë përfshirë në Raportet me Rekomandime për Bordin e Drejtorëve 318 kërkesa të cilat presin aprovimin final nga Bordi i Drejtorëve;
- Gjatë periudhës raportuese janar – shtator 2015 janë përmbyllur 92 kontrata për shitjen e banesave;
- Gjatë periudhës raportuese kërkesa të reja për blerjen e banesave janë pranuar gjithsej 121;
- Kërkesa për dokumente shtesë drejtuar palëve janë 604;

- Gjatë periudhës raportuese janë përcjell 353 kërkesa pranë Agjencisë Kosovare të Pronës për konfirmime nëse banesat për të cilat palët kanë paraqitur kërkesë për shitjen e banesave pranë AKP-së kanë qenë objekt kontesti pranë ish Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore apo tani pranë Agjencisë Kosovare për Prona;
 - Janë draftuar gjithsej 333 Memorandume Informuese për kërkesat e përcjellura në Komision për shqyrtim;
 - Gjatë periudhës nëntë mujore është bërë pranimi i 577 dokumenteve shtesë si përgjigje e palëve ndaj kërkesave të Komisionit për dokumente shtesë;
- Numër total i lëndëve të pashqyrtuara në Komision është **464**.

KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE JOLIGJORE NË PRONAT E NSH-VE

Të arriturat:

Rastet e përfunduara: Komisioni gjatë periudhës raportuese ka mbajtur gjithsejtë 5 (pesë) takime. Nga këto takime rezultojnë të jenë shqyrtuar 52 lëndë. Nga lëndët e shqyrtuara 46 lëndë i takojnë zyrës rajonale të Prishtinës, ndërkaq 6 lëndë i takojnë zyrës rajonale në Gjiilan. Të gjitha lëndët janë aprovuar nga anëtarët e Komisionit pa vërejtje. Janë përpiluar 5 procesverbalet e të gjitha mbledhjeve dhe janë nënshkruar nga anëtarët e komisionit.

Gjatë periudhës raportuese, Komisioni ka përpiluar Raportin Referues për bord, për Ndërmarrjen Shoqërore “Integj”, Gjiilan-085. Është draftuar dhe miratuar Udhëzuesi për çështjet e ekspertizës së zyrtarëve gjeodet, për nevoja të Komisionit për shqyrtimin e ndërtimeve jo ligjore në pronat e NSH-ve.

Tabela për ndërtimet joligjore		
Nr	Zyra Rajonale	Numri i rasteve të identifikuara
1	Gjiilan	266
2	Mitrovice	110
3	Peje	274
4	Prishtine	670
5	Prizren	762
	Total	2,082

Sipas shënimeve të Zyrave Rajonale të Agjencisë janë 2082 raste të ndërtimeve joligjore në pronat e NSH-ve që nga viti 2000. Ky numër nuk është përfundimtar për shkak se identifikimi i ndërtimeve joligjore nuk është përfunduar ende.

Sfidat:

Komisioni është ballafaquar me numër jo të kënaqshëm të lëndëve të raportuara në Komision nga njësitë organizative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Më poshtë ju paraqesim një tabelë rekapitulluese të gjendjes me numra të rasteve të raportuara dhe shqyrtuara në Komision.

RASTE TË RAPORTUARA NË KOMISION:	164
ZYRA RAJONALE NË GJILAN	42
ZYRA RAJONALE NË PRISHTINË	69
ZYRA RAJONALE NË MITROVICË	9
ZYRA RAJONALE NË PRIZREN	18
ZYRA RAJONALE NË PEJË	26
RASTE TË APROVUARA	74

KOMISIONI PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE - KPS

Komisioni për përcaktimin e statusit juridik të ndërmarrjeve është Komision i themeluar me Vendim të Drejtorit Menaxhues të AKP-së më 15 Gusht 2012, në përputhje me nenin 11, pika 4 dhe nenin 16, pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 2.1 të Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të aprovuara me 28 shtator 2011.

Ky komision është themeluar me qëllim të përcaktimit të statusit juridik të ndërmarrjeve dhe aseteve që bien në kompetencën administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Të dhënat lidhur me shqyrtimin e KPS-ne në periudhën raportuese janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Statusi i KPS-ve	Janar-Shtator 2015
Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni dhe aprovuar nga Bordi i Drejtoreve	Nuk ka
Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni, por të pa aprovuara nga Bordi i Drejtoreve	13 KPS
Numri i KPS-ve në proces shqyrtimi	8 KPS

